



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBETARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

Nr. 227/Prot
43

Tiranë, më 19.09. 2025

Sot me datë 19.09.2025 lidhet kjo kontratë me palë si vijon:

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Tiranë, rruga "Gëzim Erebara" pranë pallatit nr 31 Tiranë përfaqësuar nga z.Nikolin Kotherja, Titullar institucioni

Dhe

/z.nj Tecep Gjep artizan, pjesëmarrës në aktivitetin e zhvilluar me rastin e Panairit të VI-të Kombëtar të Artizanatit në Kurbin (Laç) në dt 29.09.2025

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo kontratë lidhet në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Objekti i kontratës.

Objekti i kësaj kontrate është pagesa për angazhim e /z.nj Tecep Gjep në aktivitetin e organizuar nga Qendra Kombetare e Veprimtarive Tradicionale në bashkëpunim me Bashkinë. Ky aktivitet do të zhvillohet në datën 29.09.2025 në qytetin e Laçit.

Artizani do të marrë pjesë në këtë panair me produktet e veta dhe do tregojë mjeshtërinë e prodhimit të tyre.

Neni 3

Çmimi dhe afati i Kontratës

Kjo kontrate lidhet në vlerën prej **12000 lekë** sipas marrëveshjes së bërë, ku do të mbahet edhe 15% i tatimit mbi të ardhurat.

Adresa: Rr."Gëzim Erebara" pranë pallatit nr.31 TIRANE, Shqipëri,
Tel.04 225 45 80

Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBETARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

Neni 6

Zgjidhja e Kontratës

Zgjidhja e kontratës mund të vijë:

- Si rezultat i mbarimit të afatit të caktuar.
- Si rezultat i mosplotësimit të kushteve të kontratës.
- QKVT mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

Në këtë rast palët do të njoftojnë njëra tjetrën 5 ditë para zgjidhjes së kontratës.

Neni 7

Ruajtja E Sekretit

Të gjitha të dhënat që Shoqëria e ose punonjës të saj marrin gjatë Zbatimit të kësaj kontrate Shërbimi dhe që përbëjnë informacion konfidencial, mbeten konfidenciale dhe në asnjë rast nuk mund t'u bëhen të ditura të tretëve.

Detyrimet e përcaktuara në këtë nen ngelen në fuqi edhe pas mbarimit ose prishjes së kësaj kontrate.

Neni 8

Komunikimi

Palët bien dakord që të gjitha njoftimet ndërmjet tyre të bëhen me shkrim. Këto komunikime duhet të bëhen në adresat e përmendura më lart.

Neni 9

Zgjidhja E Mosmarëveshjes

Adresa: Rr. "Gëzim Erebara" pranë pallatit nr.31 TIRANE, Shqipëri,
Tel. 04 225 45 80
Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBETARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

palët i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të detyrimeve të kontratës, në të kundërt i drejtohen Gjykatës së Rrethit Tiranë .

Kjo kontratë u hartua në 3 kopje te njevlefshme, të cilat pasi të nënshkruhen nga titullarët dhe të vulosen me vulën e përkatëse kanë vlerën e origjinalit.

PALËT E KONTRATËS

DREJTOR

Nikolin Kotherja



ARTIZAN

Gerete Gjeo
GH



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
QENDRA KOMBETARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e QKVT-së

Në kuadër të kësaj kontrate QKVT ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

1. *QKVT* ka të drejtë të kërkojë nga *Artizani* përmbushjen në kohë dhe me cilësi të objektit të kësaj kontrate.
2. *QKVT* ka detyrimin të vërë në dispozicion të *Artizanit* pa pengesa, hapësirën e parashikuar për zhvillimin e Aktivitetit si dhe teknikën e kërkuar.
3. *QKVT* ka detyrimin të paguajë "*Artizanin*" me një honorar, sipas parashikimit të bërë në kontratë në nenin 3.
4. Përformanca do të regjistrohet në formë audio dhe video nga QKVT për efekt dokumentimi, arkivimi të aktivitetit dhe promovimin e aktiviteteve që zhvillon QKVT-ja.
5. QKVT i siguron nepermjet bashkise edhe akomodimin dhe ushqimin per nje dite artizaneve

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Artizanit

Në kuadër të kësaj kontrate *Artizani* ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

1. Në bazë të kësaj kontrate "*Artizani*" merr përsipër të përmbushë të gjitha detyrimet dhe të kryejë performancën, sipas kësaj kontrate në përputhje me objektin e saj.
2. *Artizani* merr përsipër dhe garanton pjesëmarrjen në këto aktivitete.
3. *Artizani* ka detyrimin të përgjigjet me korrektësi me drejtuesit e aktivitetit
4. Në rast të mungesës së artizanit, institucioni përjashtohet nga detyrimi për kryerjen e pagesës.
5. *Artizani* dhe QKVT bien dakort të hynë në këtë marrëveshje për regjistrimin dhe transmetimin televiziv të performancës së artistit.
6. *Artizani* gëzon të drejtën e regjistrimit vizual të performancës, objekt i kësaj kontrate.
7. *Artizani* gëzon të gjitha të drejtat e mbrojtura në bazë të legjislacionit të aplikueshëm shqiptar në fuqi dhe të ligjeve ndërkombëtare të njohura nga legjislacioni shqiptar që kanë të bëjnë me mbrojtjen e veprave artistike, artizanale si dhe autoresine e tyre.

Adresa: Rr. "Gëzim Erebara" pranë pallatit nr.31 TIRANE, Shqipëri,

Tel. 04 225 45 80

Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al